



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 15.07.2016

Ref.: 634/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 43-të, të mbajtur më 06 Korrik 2016, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohen programet e studimit të Fakulteti Filozofik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” për periudhën tre vjeçare 1 tetor 2016 – 30 shtator 2019:
 - Shkenca Politike, BA, 180 ECTS, (maksimum 100 studentë për vit akademik);
 - Punë Sociale, BA, 180 ECTS, (maksimumi 50 studentë për vit akademik);
 - Filozofi, MA, 120 ECTS, (maksimum 40 studentë për vit akademik);
 - Sociologji, MA, 120 ECTS, (maksimum 30 studentë për vit akademik);
 - Psikologji shkollore dhe këshillimi, MA, 120 ECTS, (maksimum, 20 studentë për vit akademik).
- II. Kuotat e caktuar më sipër për regjistrim e studentëve në programet e studimit, vlejné nga viti akademik 2017/2018.
- III. Obligohet Fakultetit Filozofik i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri me 1 tetor 2016 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2016/2017, për arsyeje të pensionimit të mundshëm të stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.
- IV. Obligohet Fakulteti Filozofik i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri me datë 1 tetor 2016 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.

Arsyetimi

1/3

Fakulteti Filozofik i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për riakreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Shkenca Politike	BA	180	Afrim Hoti, Sejdi Rexhepi, Bardhok Bashota
2	Punë sociale	BA	180	Lulzim Dragidella, Vjollca Krasniqi, Arben Hajdari,
3	Filozofi	MA	120	Kadri Metaj, Hasnije Ilazi, Bekim Baliqi
4	Sociologji	MA	120	Agim Hyseni, Anton Berishaj, Ibrahim Berisha
5	Psikologji shkollor dhe këshillimi	MA	120	Aliriza Arënliu, Liridona Jemini-Gashi, Zamira Hyseni-Duraku

AKA ka organizuar vizitën në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” më 16.05.2016, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Prof. Dr. Melita Kovacevic, Prof. Dr. Marijana Majdak, Prof. Dr. Pavo Barisic, Prof. Dr. Christian Papilloud, Prof. Stephen Adam.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 06 Korrik 2016 ka vlerësuar aplikacionin e Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi iu dërgohet:

- Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë